



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM BERAT**

Berat, më 31.05.2023

N J O F T I M

PËR VENDE TË LIRA PUNE

**NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË
PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM BERAT"**

Në mbështetje të Ligjit nr 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", si dhe Urdherit nr.54, date 18.04.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm".për "Strukturën organike të Prokurorisë Prane Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat", të Ligjit nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar, Prokuroria Prane Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, shpall konkurrimin për nëpunës civil dhe nepunes mbeshtetes Proçedura e rekrutimit, përzgjedhjes dhe periudha e provës do të realizohet për pozicionet e punes:

Kërkohet të punësohen në Prokurorinë Berat 4(kater) punonjës në pozicionet;

- a) Sekretar prane prokuroreve 1(nje)
- b) Specialist - IT 1(nje)
- c) Specialist - arkivist, 1(nje)
- d) Punonjës shërbimi 1(nje)

I- Kushte të përgjithshme

- a) të jetë shtetas shqiptar
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur
- d) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe të mos jetë nën hetim;
- f) ndaj tij/saj të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil apo administrata shtetërore që nuk është shuar sipas këtij ligji;
- g) të ketë përfunduar arsimin lartë (për pozicionet a, b dhe c.)
- h) të ketë eksperiencë pune në administratën publike (për pozicionet a, b, c)

- i) Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë.
- j) Të ketë aftësi komunikuese dhe pune në grup.
- k) Të ruajë sekretin hetimor.
- l) Të ketë sjellje etike dhe morale

Data e fundit e dorëzimit të dokumentave: deri 11.06.2023 ora 16.00

Vendi i dorëzimit të dokumentave: Prane Kryesekretarise se Prokurorisë Berat

****Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të gjitha procedurat.***

Konkurrimi për vendet e punës se mesiperme, në Prokurorinë Prane Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat do të bazohet në:

1. Ligjin nr.97/2016, “Per organizimin e funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme;
2. Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar,

B) Konkurrimi do të zhvillohet në dy faza:

I. Faza e parë:

- Verifikimi paraprak i kandidatëve për plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe atyre të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim
- Komisioni I pranimit në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e mbylljes së pranimit të tyre, do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim.
- Kandidatet që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfabetik e cila administrohet nga Komisioni dhe do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe në hyrjen kryesore të Prokurorisë Berat.
- Kandidatet, që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurim, renditen në një listë të veçantë në të cilën regjistrohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk publikohet dhe administrohet nga Komisioni, i cili njofton në mënyrë individuale kandidatët që nuk janë kualifikuar.
- Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtuesit të Prokurorisë Berat, brenda 5 (pesë) ditëve kalendrike nga data e shpalljes së listës. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendrike nga data e depozitimit të ankesës

II. Faza e dytë përbëhet nga vlerësimi i kandidatëve që përfshin:

- Vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore
- Vlerësimi me shkrim.
- Intervista e strukturuar me gojë.

C) Për pranimin në shërbimin civil, kandidati duhet të plotësojë **kërkesat e përgjithshme** sipas nenit 21, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si më poshtë:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.

I - Kushtet e veçanta për pozicionin “Sekretar prane prokuroreve”

- Të ketë mbaruar studimet e larta në Drejtësi (3+2), ose i barazvlefshëm me të, vërtetuar me diplomën dhe listen e notave përkatëse
- Të njohë mirë kompjuterin, vërtetuar me dokumentin përkatës
- Të ketë njohuri të mira gjuhësore e drejtshkrimi
- Të ketë njohuri të mira minimalisht të një gjuhe të huaj,
- Të ketë përvojë profesionale minimalisht për një periudhë një vjeçare
- Të prezantojë etikë, qytetari dhe nivel performance të denjë për institucionet shtetërore dhe të pranojë e realizojë testimin bazë që përfshin komunikim të lirë me komisionin

II- Kushtet e veçanta për pozicionin “Specialist IT”

- Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor ose Profesional” në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 1 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë eksperiencë në menaxhimin e projekteve TIK.
- Të ketë eksperiencë në hartimin e politikave të brendshme IT dhe planifikime në fushën IT.
- Të ketë njohuri shumë të mira për infrastrukturën e IT dhe sistemet të cilat implementohen mbi to.
- Të ketë njohuri në instalimin, implementimin, formatime etj të pajisjeve kompjuterike

- Të prezantojë etikë, qytetari dhe nivel performancë të denjë për institucionet shtetërore dhe të pranojë e realizojë testimin bazë që përfshin komunikim të lirë me komisionin

III- Kushtet e veçanta për pozicionin “Specialist arkivist”

- Të ketë mbaruar studimet e larta dhe master (3+2) në Drejtësi ose Histori.
- Të ketë të paktën një vit eksperiencë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me Prokurorinë ose Gjykatën
- Të njohë legjislacionin mbi Arkivat
- Të ketë aftësi të mira komunikuese në punë dhe në grup;
- Të prezantojë etikë, qytetari dhe nivel performancë të denjë për institucionet shtetërore dhe të pranojë e realizojë testimin bazë që përfshin komunikim të lirë me komisionin

IV- Kushtet e veçanta për pozicionin “punonjës shërbimi”

-Të ketë mbaruar minimalisht studimet e mesme, (studimet e larta do të jenë përparësi)

-Të ketë aftësi të mira komunikuese

-Të ketë aftësi të mira komunikuese në punë, në grup dhe me qytetarët;

-Të prezantojë etikë, qytetari dhe nivel performancë të denjë për institucionet shtetërore dhe të pranojë e realizojë testimin bazë që përfshin komunikim të lirë me komisionin

-Dokumentacioni i kërkuar për të 4 (kater) pozicionet

- kërkesë me shkrim, me adresë banimi, adresë elektronike dhe numër telefoni
- CV të përgjithshme,
- Kopje të kartës së identitetit
- Certifikatë familjare
- Raport mjeko-ligjor
- Diploma përkatëse e studimeve dhe Lista e notave të noterizuara
- Dokumente të tjerë që tregojnë njohuri apo aftësi të veçanta
- Vërtetim për gjendjen gjyqesore (Dëshmi penaliteti),
- Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria
- Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja

Për informacion të mëtejshëm kandidatët mund të paraqiten pranë Kryesekretarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Berat.

Njoftimi për kandidatët do të afishohet në mjediset e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, vendin e njoftimeve të Prokurorisë, si dhe në faqen zyrtare të

Prokurorisë së Përgjithshme. Mënyra e dorëzimit me postë ose e drejtpërdrejtë në protokollin e institucionit me adresë: Prokuroria Berat/zyra e protokollit me adresë: L.”30 Vjetori” Bul. “Republika, Berat

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore;
- Vlerësimi me shkrim;
- Intervista e strukturuar me gojë.
- Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:
- Për vlerësimin e jetëshkrimit (cv) të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore, **15 pikë**; - Për vlerësimin me shkrim, **60 pikë**.
- Për intervistën e strukturuar me gojë, **25 pikë**;

i) Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët do të bëhet nëpërmjet adresave të email, me mesazhe në numrin e celularit të kandidatit, në faqen e internetit dhe tek dera e Prokurorisë Berat.

Për me shume informacion mund te vizitoni edhe faqen në internet: www.pp.gov.al.